

LIGJ
Nr.9332, datë 6.12.2004

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 1/1 e nenit 3 shfuqizohet.

Neni 2

Pas pikës 6 të nenit 13 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Kur mallrat transferohen në bazë të një kontrate, e cila parashikon marrjen me qira ose shitjen me këste, pavarësisht nga çasti i kalimit të pronësisë, detyrimi për TVSH-në lind mbi vlerën e plotë të mallit dhe llogaritet mbi pagesat e vlerës së plotë të kësteve për mallin e vënë në dispozicion për përdoruesin.”.

Neni 3

Në nenin 20 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Furnizimi i ndërtesave është një furnizim i përjashtuar deri më 31 dhjetor 2005.”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Furnizimi i ndërtesave të banimit dhe i tokës mbi të cilën ato qëndrojnë, me përjashtim të shitjes së parë të ndërtesave të reja të banimit, është furnizim i përjashtuar, duke filluar nga data 1 janar 2006.

5. Dhënia me qira e ndërtesave të banimit, të cilat janë tatuar me TVSH në shitje, është furnizim i përjashtuar duke filluar nga data 1 janar 2006.”.

Neni 4

Pas nenit 25/5 shtohet neni 25/6 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/6

1. Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare, të destinuara për t'u rieksporuar për personat e tatueshëm të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv, është furnizim i përjashtuar.

2. Ministri i Financave përcakton me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e përjashtimit.”.

Neni 5

Në nenin 26/1, pas shkronjës “dh” shtohen shkronjat “e” dhe “ë” me këtë përmbajtje:

“e) importimi i mallrave nga NATO-ja dhe organizmat e saj në kuadër të operacioneve, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare;

ë) importimi i materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet e Aleancës së NATO-s dhe ato partnere.”.

Neni 6

Shkronja “c” e nenit 31 ndryshohet si më poshtë:

“c) furnizimet e mallrave e të shërbimeve, në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve, me përjashtim të shërbimeve navigacionale ajrore në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 7

Neni 43 “E drejta e ankimit” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

E drejta e ankimit

1. Çdo person, që ka kërkuar një rishqyrtim në mbështetje të nenit 42, nëse nuk është dakord për ndonjë arsye me rezultatet e rishqyrtimit, ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Apelit të Tatimeve dhe më pas në gjykatë kundër vlerësimit tatimor.

2. Ankimi bëhet brenda 30 ditëve nga data e rishqyrtimit dhe në të duhet të paraqiten arsyet përse personi që bën ankimin nuk ka rënë dakord me vlerësimin tatimor dhe rishqyrtimin.

3. Në gjykimin e një ankimi, Komisioni i Apelit të Tatimeve ose gjykata ka të drejtë të vendosë që vlerësimi tatimor, kundër të cilit personi ankohet, të konfirmohet, të ndryshohet ose të anulohet.

4. Organet tatimore, në mbështetje të këtij neni, zbatojnë çdo vendim të gjykatës.”.

Neni 8

Pika 2 e nenit 49 shfuqizohet.

Neni 9

Shkronja “a” e pikës 2 të nenit 50 ndryshohet si më poshtë:

“a) personi i tatueshëm ka bartur një shumë të kreditimit tatimor për 3 muaj radhazi në bazë të pikës 1 të këtij neni ”.

Neni 10

Shkronja “b” e nenit 53 “Interesat për rimbursimin” ndryshohet si më poshtë:

“ b) kur organet tatimore nuk bëjnë rimbursimin e TVSH-së për një person, në përputhje me nenin 50, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës në njërin nga format e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 39 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, detyrohen të paguajnë interesat e përcaktuar në nenin 44 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4436, datë 17.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu